



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

Nr. 03/112 Prot.

Lezhë, më 10.03. 2020

VENDIM

Nr. 5, datë 03.03.2020

PËR
MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR,
PËR PRODHIM HIDROENERGJIE "HEC ULËZ", NJËSIA ADMINISTRATIVE
ULËZ, BASHKIA MAT, PËR SUBJEKTIN "KURUM INTERNATIONAL" SH.A

Në mbështetje të shkronjës "b" të pikës 2, të nenit 12, neni 41, pikës 2 të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar, V.K.M –së Nr. 696, datë 30.10.2019 "Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre" dhe të VKM-së nr.416, datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore", me propozimin e Zyrës së Administrimit të Burimeve Ujore Ishëm – Erzen – Mat, Këshilli i Basenit Ujor Mat.

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rinovimit të lejes " Për prodhim hidroenergjie, Hec Ulëz " subjektit "KURUM INTERNATIONAL" SH.A.
1. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Ishëm – Erzen – Mat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Anastasi Meçi



KRYETAR

Gjokë Jaku